

**BRUNILDA VËRÇANI**

**FORMAT E PASHTJELLUARA TË FOLJES NË GJUHËN E  
SOTME GJERMANE NË PËRQASJE ME ATO TË SHQIPES  
STANDARDE: PËRGJEGJËSET E TYRE NË SHQIPEN  
STANDARDE**

**Abstrakt**

Format e pashtjelluara të foljes në gjuhë të ndryshme europiane, të vjetra a të reja, shfaqen me një origjinalitet të theksuar. Këtë e dëshmon edhe krahasimi i tyre qoftë edhe vetëm në dy gjuhë indoeuropiane siç janë gjermanishtja dhe shqipja. Ndryshimet konsistojnë në numrin e formave të pashtjelluara, në trajtat e shfaqjes së tyre, në tiparet morfologjike si dhe në funksionet sintaksore. Dallimet shpjegohen me evoluimin e tyre në kohë.

Por edhe ngjashmëritë midis formave të pashtjelluara nuk mungojnë. Ato afrojnë në ekzistencën si kategori morfosintaksore, në gërshetimin e tipareve foljore me ato të pjesëve të tjera të ligjëratës dhe sidomos në funksionet sintaksore, sepse në çdo gjuhë gati po ato funksione kryhen nga forma të ndryshme të pashtjelluara, sipas parimit mungesa e një forme kompensohet nga një formë tjetër e pashtjelluar ose nga një mjet tjetër gramatikor. Pra çdo gjuhë arrin që me format e pashtjelluara që zotëron të kompenzojë format munguese; në disa raste vijnë në ndihmë edhe mjete të tjera gramatikore.

Në këtë punim synohet të bëhet një përjasje e formave të pashtjelluara të gjermanishtes me ato të shqipes standarde në rrafshin morfosintaksor.

Kjo përjasje do të konkretizohet me shembuj të shkëputur nga romani “Mali magjik” i shkrimtarit gjerman Thomas Mann, roman i cili është përkthyer edhe në gjuhën shqipe.

**Hyrje**

Gjuha e sotme gjermane njih dy forma të pashtjelluara të foljes: 1) Infinitivi, 2) Participi, i cili shfaqet në dy trajta Participi I dhe Participi II<sup>1</sup>

Disa gjuhëtarë njohin, përveç këtyre formave, edhe një formë tjetër të quajtur Gerundivum.<sup>2</sup>

**1. Infinitivi**

Infinitivi është forma bazë e foljes që nuk përcaktohet më tej nëpërmjet vetës, numrit, kohës e mënyrës.<sup>3</sup> Ai shihet si forma me të cilën jepet ose

---

<sup>1</sup> Helbig / Buscha, *Deutsche Grammatik*, Leipzig, 1996, f. 105.

<sup>2</sup> Sommerfeldt / Starke, *Grammatik der Gegenwartssprache*, Tübingen, 1998.

emërtohet një folje ose forma me të cilën folja përfaqësohet në fjalor. Infinitivi gërsheton kryesisht tipare të foljes dhe të emrit.

## 2. Participi

Participi (Partizip) përcaktohet përgjithësisht si forma foljore e pashtjelluar që ka tiparet e foljes dhe të mbiemrit<sup>4</sup> ose si formë foljore që zë vend midis foljes dhe mbiemrit<sup>5</sup>. Por participi i gjermanishtes ka edhe tipare të ndajfoljes.

Në gjuhën shqipe standarde, tradita njih 6 forma të pashtjelluara të foljes:

1. Pjesorja (punuar)
2. Përcjellorja (duke punuar)
3. Forma e pashtjelluar mohore (pa punuar)
4. Forma e pashtjelluar e tipit për të punuar, që herë - herë quhet paskajore me vlera të kufizuara
5. Forma e pashtjelluar e tipit me të punuar
6. Forma e pashtjelluar e tipit një të punuar

Siç shihet janë emërtuar dhe kategorizuar përfundimisht vetëm pjesorja (punuar), përcjellorja (duke punuar); 4 të tjerat jo. Megjithatë ka gjuhëtarë të cilët në studimet e tyre bëjnë një tjetër kategorizim dhe emërtim të formave të pashtjelluara, siç është trajtimi i këtyre formave nga Prof. Mehmet Çeliku. Sipas tij në gjuhën e sotme shqipe duhen njohur tri forma të pashtjelluara dhe disa trajta të shfaqjes së tyre:

1. Forma e pashtjelluar e gerundit që ka dy trajta rasore: trajta e kallëzores të punuar dhe trajta e rrjedhores së punuari
2. Forma e pashtjelluar e përcjellores që ka dy trajta: duke punuar (përcjellore pohore) dhe pa punuar (përcjellore mohore)
3. Forma e pashtjelluar e pjesores që ka dy trajta: punuar – trajtë pa mbaresë dhe i (e, të, së) punuar – trajtë me mbaresë të përparme.

Përqsaja e formave të pashtjelluara të gjermanishtes me ato të shqipes standarde, gjetja e formave apo mjeteve gjuhësore përgjegjëse në gjuhën shqipe, në këtë punim, do të mbështetet në trajtimin e ri, por duke shfrytëzuar edhe arritjet kryesore të traditës për këtë kategori foljore.

Le të shohim tani tiparet morfologjike dhe funksionet sintaksore të formave të pashtjelluara të gjuhës gjermane dhe të gjejmë përgjegjëset e tyre në gjuhën shqipe. Siç e pamë numri i formave të pashtjelluara foljore në të dy gjuhët nuk është i njëjtë, kështu që do të shohim cilat janë ato mjete

<sup>3</sup> Duden, *Deutsches Universalwörterbuch*, Mannheim, 2001, f. 829.

<sup>4</sup> Duden, *Deutsches Universalwörterbuch*, Mannheim, 2001, f. 371.

<sup>5</sup> Sommerfeldt / Starke, *Einführung in die Grammatik der Gegenwartsprache*, Tübingen, 1998, f. 128.

gramatikore, të cilat kompensojnë mungesën e formave të caktuara të pashtjelluara.

### I. Infinitivi

Siç u përmend më lart, infinitivi gërsheton tipare të foljes dhe të emrit. Infinitivi i gjuhës gjermane shoqërohet shpesh nga pjesëza **zu**, e cila në shumë funksione të infinitivit është e detyrueshme, në disa përdorime të veçanta të tij është fakultative dhe në disa raste të tjera ajo mungon në mënyrë të detyrueshme<sup>6</sup>.

Infinitivi në funksione të ndryshme, përdoret i lidhur me një folje tjetër, e cila zotëron kategoritë gramatikore të numrit, vetës, mënyrës etj., pra zgjedhohet. Infinitivi nuk zotëron asnjë nga këto kategori dhe si rrjedhim nuk ndryshon formë sipas këtyre kategorive:

*Du sollst **kommen** (Ti duhet të **vish**) Du solltest **kommen** (Ti duhej të **vije**).*

Infinitivi mund të lidhet me një folje ndihmëse, folje gjysëmndihmëse (modale), folje me kuptim të plotë, me emra ose përdoret i izoluar në fjali urdhërore.

*Er hatte nicht die Kraft, sich darüber Gedanken **zu machen**. (Ai nuk e kishte forcën të mendonte për këtë)...und können nicht aus den Augen **sehen**. (...nuk mund të shihnin nga sytë) "Placet experiri", hatte Hans Castorp die Frechheit **zu antworten**. (... "Placet experiri", kishte për t'iu përgjigjur Hans Kastorpi paturpësisë.) Er hatte etwas wichtiges **zu sagen**. (Ai kishte për të thënë diçka të rëndësishme) **Aufstehen!** (Çohuni) Er war nicht fähig, sich davon **zuzuführen**. (Nuk ishte i zoti ta drejtonte këtë).*

### Funksionet sintaksore të infinitivit

#### 1. Funksioni kryefjalor

Në funksionin e tij si kryefjalë infinitivi shoqërohet gjithnjë nga pjesëza **zu**. Si forma konkurruese të infinitivit shfaqen edhe sifjali të nënrenditura ose emërzime të tij<sup>7</sup>. Funksionin e një kryefjale infinitivi e ka edhe kur folja që zgjedhohet, me të cilën ai lidhet, është një folje këpujore pavetore, që së bashku me një mbiemër a emër përbëjnë kallëzuesin. Si folje këpujore shfaqet folja sein (jam). Edhe në këtë rast shfaqen si forma konkurruese të infinitivit, fjali të nënrenditura dhe emërzime të infinitivit.

*Diesen Mann **zu kennen**, war nicht möglich. (Nuk ishte e mundur ta njihje këtë burrë).*

#### 2. Infinitivi si pjesë e kallëzuesit foljor

Infinitivi shfaqet si pjesë e kallëzuesit në lidhje me një folje ndihmëse, me folje modale (gjysmëndihmëse), me folje të ngjashme me ato modale, ose me folje modale aspektore.

---

<sup>6</sup> Buscha / Zoch, *Der Infinitiv*, Leipzig, 1992, f. 12.

<sup>7</sup> Helbig / Buscha, *Deutsche Grammatik*, Leipzig, 1996, f. 118.

Në gjuhën shqipe në këto raste përdoret mënyra lidhore, sifjalia e nënrenditur dhe gerundi.

### 3. Infinitivi në funksionin e kundrinorit

Në këtë funksion ai shoqërohet nga pjesëza *zu* me përjashtim vetëm të disa rasteve. Në gjuhën shqipe përdoret mënyra lidhore. *Er war nicht gewohnt, zu philosophieren...* (S'ishte mësuar të filozofonte...) *Sie versprach, Bier zu bringen, und brachte es.* (Premtoi të sillte birrë dhe e solli)... *dies aber zu verbergen suchte...* (U përpoq ta fshihte këtë...) ... *vergaß, das Bild aufzuhängen...* (...Harroi ta varte foton...).

### 4. Infinitivi si rrethanor

Ndërsa numri i foljeve që lidhet në mënyrë të detyrueshme me një infinitiv është i kufizuar, për lidhjet e një foljeje me kuptim të plotë me një infinitiv me lidhëzat *um*, *anstatt*, *ohne*, + pjesëzën **zu**, siç u përmend më lart, nuk ka kufizime sintaksore. Këto lloje infinitivësh nuk varen nga valenca e foljes, dalin në funksionin e rrethanoresh (të lirë/fakultativë) dhe u përgjigjen fjalive të caktuara të nënrenditura<sup>8</sup>.

a. *Um...zu* (për të) fjali qëllimore (Finalsatz)

b. *(an)statt ... zu* fjali të zëvendësimit (Substitutivsatz)

c. *Ohne ... zu* fjali mënyrore ose rrjedhimore mohore (Modal ose Konsekutivsatz).

Edhe në këto raste infinitivit të gjermanishtes i përgjigjet lidhorja, gerundi, sifjalia e varur ose trajta e percjellores mohore në shqipen standarde. ..., *so dass er den Kopf schräg zurücklegen musste, um ihnen ins Gesicht zu sehen...* (... kështu që iu desh të kthente kokën anash, për t'i parë në fytyrë...) ... *kann man ... auf dem Balkon bleiben, ohne zu frieren.* (mund të rrish në ballkon, pa pasur ftohtë).

### 5. Infinitivi si atribut

Infinitivi shfaqet zakonisht i lidhur me një folje që zgjedhohet, por në disa raste ai mund të lidhet edhe me emra ose mbiemra, lidhje në të cilat ai del në funksionin e një atributi. *Er hatte Lust zu fliehen.* (Ai kishte dëshirë të arratisëj.) *Es ist Zeit, zu Bett zu gehen.* (Është koha për të shkuar në shtrat.) *Er war nicht fähig, sich davon zuzuführen.* (Nuk ishte i zoti ta drejtonte këtë).

Në shqipen standarde përdoren lidhorja, gerundi me parafjalën për.

## II. Participi

Participi (Partizip) siç u përmend më lart përcaktohet përgjithësisht si forma foljore e pashtjelluar që ka tiparet e foljes dhe të mbiemrit ose si formë foljore që zë vend midis foljes dhe mbiemrit. Por participi i gjermanishtes ka edhe tipare të ndajfoljes. Participet zotërojnë valencën e foljes bazë të fjalisë. Ata kanë gjithashtu kategorinë e kohës relative dhe të diatezës së foljes.

<sup>8</sup> Po aty.

Ato mund të vendosen para një emri të caktuar dhe në këtë rast mund të lakohen si mbiemrat, pra të ndryshojnë sipas gjinisë, rasës e numrit të emrit<sup>9</sup>.

Participi i gjermanishtes, sikurse edhe infinitivi ka një përdorim shumë të gjerë. Përdorimi i tij ngjan me atë të një mbiemri; ai në gjermanisht del në përdorim atributiv, adverbial dhe predikativ<sup>10</sup>.

Gjuha gjermane njih dy participe: particip I ose participi i së tashmes (Partizip Präsens) dhe particip II ose participi i së shkuarës (Partizip Perfekt), ose pjesore e kryer. Gjuha shqipe nuk e ka participin e së tashmes. Funkcionet e tij në shqipe i mbulojnë përcjellorja dhe sifjalia përcaktore, ndërsa participit II të gjermanishtes në gjuhën shqipe i përgjigjet në shumicën e rasteve pjesorja. **Participi I.**

Participi I formohet duke i shtuar infinitivit të foljes prapashtesën **-d**: *singen – singend fragen – fragend lachen – lachend*. Participi I e paraqet veprimin a gjendjen e shprehur nga folja nga e cila është përfutur si të vazhdueshëm, të papërfunduar. *Nein, das ist es nicht-, sagte er kopfschüttelnd*. (Jo, nuk është kjo, - tha ai duke tundur kokën) *Sie lachte eben, im Bette sitzend...* (Qeshte duke ndenjtur ulur në shtrat...).

#### **Particip II**

Forma foljore me të cilën në gjermanisht formohet perfekti (e kryera) quhet pjesore e kryer (Partizip Perfekt) ose pjesore II (Partizip II)<sup>11</sup>.

Participi II formohet duke i shtuar rrënjës së foljes parashtesën *ge-* dhe prapashtesën *t* për foljet me zgjedhim të rregullt dhe prapashtesën *-en* për foljet e parregullta. Në disa raste participi formohet pa parashtesën *ge*. Në varësi të foljes nga e cila formohet participi II ka kuptim vepror (aktiv) ose pjesor (passiv). *machen – gemacht (bëj – bërë) sehen – gesehen (shoh – parë)*.

Në përdorimet e tij funksionale Participi I dhe II lidhet me emra ose me folje. Kur lidhet me një emër ai përdoret si mbiemër duke marrë tiparet e tij si gjininë, rasën, numrin, mbaresat rasore dhe shkallët e mbiemrit. Një grup studiuesish në këtë përdorim të tij e klasifikojnë atë si mbiemër dhe jo si particip<sup>12</sup>.

*Der Junge lauschte mit sich festsehenden Augen...* (Djali përgjonte me sytë, që i kishte ngulur fort... / duke i ngulur sytë fort...).

<sup>9</sup> Duden, *Die Grammatik*, Mannheim 2005.

<sup>10</sup> Sommerfeldt / Starke, *Einführung in die Grammatik der Gegenwartssprache*, Tübingen 1998, f. 129.

<sup>11</sup> Duden, *Die Grammatik*, Mannheim 2005 f. 447. Valentin Paul: *Über Nicht-Partizipien und Partizipien im heutigen Deutsch*, në Bresson, Daniel / Dalmas, Martine (Hrsg.): *Partizip und Partizipialgruppen im Deutschen*. Tübingen 1994.

<sup>12</sup> Valentin Paul, *Über Nicht-Partizipien und Partizipien im heutigen Deutsch*, në Bresson, Daniel / Dalmas, Martine (Hrsg.): *Partizip und Partizipialgruppen im Deutschen*. Tübingen 1994.

*Man sah nichts als zugekramfte Augen, offene Münder und verdrehte Oberkörper. (Nuk shihje gjë tjetër veç syve të rrudhur, gojëve të hapura dhe trupave të përdredhur.)*

Këto lidhje mund të zgjerohen më tej me gjymtyrë të tjera, që vendosen mes nyjës së paravendosur të emrit dhe participit mbiemër. Këto participe të zgjeruara formojnë ato që në gjermanisht quhen ndërtime participale (Partizipialkonstruktionen / Partizipalgruppe)<sup>13</sup>. Këtyre ndërtimeve në gjuhën shqipe iu përgjigjet fjalia përcaktore.

*... wenn der Geist der Neuzeit die weitbekannt glänzenden Siege gefeiert hatte.... wenn der Geist der Neuzeit die Siege gefeiert hatte, die weitbekannt glänzte.*

Krahas përdorimit të participit I si mbiemër në lidhjet particip + emër, ai shfaqet edhe në lidhje me një folje të zgjedhueshme. Në këto lidhje ai nuk ndryshon formë. Kategoritë foljore (kohë, mënyrë etj.) i mbart folja që zgjedhohet. Në këtë përdorim participi I ngjet mjaft me përcjelloren e shqipes standarde.

*... dass er glänzend an seinem Platze war... (... qëndronte në vendin e tij duke rrëzëlyer...) ... dass er glänzend an seinem Platze war / ist / sei ...*

#### **Funksionet sintaksore të participit I dhe II Participi si atribut**

Në këtë funksion ai i referohet një emri dhe ka një vend të ngulitur në fjali. Ndërtimet participale atributive mund të ndërkëmbehen me një fjali përcaktore, pa e prishur kuptimin.

*... welche die **herrschende** Oberschicht der **handeltreibenden** Stadtdemokratie ihren Kindern vererbt. ... ein richtiges Konzert mit Stuhlreihen und **gedruckten** Programmen... (...një koncert i vërtetë me radhë karrigesh dhe programe të shtypura...) Ein richtiges Konzert mit Stuhlreihen und Programmen, die gedruckt worden waren.*

#### **2. Participi në funksionin adverbial**

Në këtë funksion participi i referohet një foljeje të shtjelluar të fjalisë. Në ndërtimet adverbial kemi të bëjmë me një veprim të shprehur nga folja e shtjelluar e fjalisë, veprim i cili karakterizohet më tej nga ndërtimi adverbial sipas mënyrës, kohës, shkakut etj. të kryerjes së veprimit. Ndërtimet adverbial lejojnë mundësi të ndryshme semantike të interpretimit: a) mënyrore, b) kohore, c) shkakore, d) kushtore, e) lejore<sup>14</sup>.

*Er schüttelte **lächelnd** den Kopf... (Tundi kokën duke qeshur) Sie lachte eben, im Bette **sitzend**... (Qeshte duke ndenjtur ulur në shtrat) ... er ... **heimkehrend** bei ihr einsprach... (iu drejtua asaj duke u kthyer në shtëpi / tek kthehej në shtëpi).*

<sup>13</sup> Rath R., *Die Partizipialgruppe in der deutschen Gegenwartssprache*, Düsseldorf, 1971.

<sup>14</sup> Helbig / Buscha, *Deutsche Grammatik*, Leipzig 1996, f. 666 -668.

*Wer hat noch einen?, - rief er nach beiden Seiten aus, den linken Unterarm noch auf die Tischplatte gestützt. (Kush ka edhe një?, - thirri nga të dy anët, me krahun e majtë mbështetur mbi tavolinë.).*

### 3. Ndërtimet participale predikative

Këto ndërtime i referohen foljes së shtjelluar të fjalisë. Mund të jenë gjymtyrë të lira, pra nuk kanë rend të ngulitur në fjali *Settembrini schritt schnurrbartkräuselnd zu seinem Platz. (Setembrini shkoi në vendin e tij duke përdredhur mustaqet.) Schnurrbartkräuselnd, schritt Settembrini zu seinem Platz. (Duke përdredhur, mustaqet Setembrini shkoi në vendin e tij.)* Edhe pse rendi i gjymtyrëve ndryshoi, kuptimi i fjalisë nuk u prish.

Ndërtimet participale kallëzuesore perifrazohen në sifjali të nënrenditura ose kryesore me lidhëzën **und** (dhe).

*Er schüttelte lächelnd den Kopf (Tundte kokën duke qeshur) - Er schüttelte den Kopf, indem er lachte. - Er schüttelte den Kopf und er lachte. (Tundte kokën dhe qeshte.).*

Në këtë funksion participi II lidhet me foljet ndihmëse haben, sein, werden. Këto lidhje shërbejnë për formimin e perfektit, plusquamperfektit dhe pësorës së procesit. ... *hatte ihn zu seiner Ausbildung nach England geschickt. (... e kishte dërguar për t'u arsimuar në Angli.).*

### Gerundivum

Disa gjuhëtarë si Sommerfeldt apo Starke, njohin, përveç infinitivit dhe participit, edhe një formë tjetër të pashtjelluar të quajtur gerundivum.

Fjalori i gjuhës gjermane Duden "Deutsches Universalwörterbuch" e përcakton kështu gerundivumin: "Gerundivumi është formë foljore që funksionon si mbiemër, formë me kuptim pësor (passiv) që shpreh një domosdoshmëri."

Kjo formë ka pamjen e një participi I të lidhur me pjesëzën zu.

*Die zu erledigende Arbeit (Puna që është për t'u kryer.) Der zu lesende Text. (Teksti që është për t'u lexuar.).*

Meqë ai ka kuptim pësor formohet vetëm nga folje transitive. Komponentët modalë që përmban ai mund të perifrazohen me foljen modale müssen (duhet) e sipas kontekstit edhe können (mund):

*Die Arbeit, die erledigt werden muss (Puna që duhet kryer.)*

Gerundivumi përdoret vetëm si atribut ose kallëzuesor dhe jo si rrethor. Gjatë përdorimit si kallëzuesor ai e humbet prapashtesën d dhe dallon nga infinitivi i së tashmes vetëm semantikisht:

*Der Text ist zu lesen. (Teksti është për t'u lexuar.) Der Text muss gelesen werden. (Teksti duhet lexuar.)*

Kjo formë e pashtjelluar përdoret shpesh në gjuhën standarde, por jo në gjuhën e përditshme dhe atë të letërsisë artistike.

Gerundivumit të gjermanishtes i përgjigjet në gjuhën e sotme shqipe ndërtimi folje modale + pjesore (puna do / duhet kryer), që, sipas disa gjuhëtarëve vlerësohet si folje modale + paskajore e hershme sintetike e mbarë shqipes; Ndërkaq K. Cipo në gramatikën e tij e quan gjithashtu gerundiv të krahasueshëm me gerundivin e latinishtes.

### **Përfundime**

Numri i formave të pashtjelluara në të dy gjuhët nuk është i njëjtë. Gjermanishtja ka një infinitiv shumë funksional. Funksionet e infinitivit të gjermanishtes në shqipen standarde i kryen një sistem i tërë mjeteve gramatikore: mënyra lidhore, emri foljor prapashtesor dhe asnjans, gerundi, përcjellorja mohore, sifjalia e nënrenditur. Të gjitha këto mjete përdoren në funksion kryefjalor, kundrinor, kallëzuesor, rrethanor, atributiv.

Për të shprehur marrëdhënie qëllimore, sifjalive të varura qëllimore në gjermanishte me lidhëzën qëllimore um ...zu në shqipe i përgjigjet për + gerund, lidhorja ose emri foljor. (për të studiuar, të punoja, për punë):

Infinitivit të thjeshtë të shoqëruar nga pjesëza zu të gjermanishtes i përgjigjet në gjuhën shqipe gerundi me parafjalën për: i zoti *për të folur / fähig zu sprechen*

Ndërtimit lidhëza ohne ... zu + infinitiv i përgjigjet përcjellorja mohore në gjuhën shqipe:

Er trat herein, *ohne zu begrüßen*. Ai hyri brenda *pa përshëndetur*.

Infinitivit të përdorur si kundrinor në gjermanishte i përgjigjet një sifjali e nënrenditur kundrinore në gjuhën shqipe.

Formës tjetër të pashtjelluar shumë të pasur formalisht dhe funksionalisht të participit të gjermanishtes i përgjigjen në gjuhën shqipe përcjellorja pohore (duke mësuar) për particip I (lernend) dhe pjesorja (mësuar) për particip II (gelernt). Ndërtimeve participale të gjermanishtes iu përgjigjet në shqip fjalia përcaktore.

### **BIBLIOGRAFI**

- Buscha / Zoch, *Der Infinitiv*, Leipzig, 1992.  
Çeliku, M., *Format e pashtjelluara të foljes në gjuhën e sotme shqipe*, Tiranë 2000.  
Çeliku, M., *Gramatika praktike e gjuhës shqipe*, Tiranë 1998.  
Çeliku, M., *Problemi i paskajores në shqipen standarde* in *Republika*, 29.10.2002.  
Daniel / Dalmas, Martine (Hrsg.), *Partizip und Partizipialgruppen im Deutschen*.Tübingen, 1994.  
Demiraj, Sh., *Rreth disa problemeve të paskajores në gjuhën shqipe* në SF 1, Tiranë 1969.  
Duden, *Deutsches Universalwörterbuch*, Mannheim 2001, f. 829.  
Duden, *Die Grammatik*, Mannheim, 2005.  
Eisenberg, P., *Grundriss der deutschen Grammatik*, Stuttgart, 1994.

Format e pashtjelluara të foljes në gjuhën e sotme gjermane në përfaqje...

---

- Engel, U., *Deutsche Grammatik* München, 2004.  
*Gramatika e gjuhës shqipe*, Akademia e Shkencave, Tiranë, 1995.  
Hall / Scheiner, *Übungsgrammatik für Fortgeschrittene*, Ismaning, 2001, f. 174.  
Helbig / Buscha, *Deutsche Grammatik*, Leipzig 1996.  
Hentschel / Weydt, *Handbuch der deutschen Grammatik*, Berlin, 1994.  
Mann, T., *Der Zauberberg*, Berlin, 1924/16. Auflage, 2004.  
Rath, R., *Die Partizipialgruppe in der deutschen Gegenwartssprache*, Düsseldorf, 1971.  
Sommerfeldt / Starke, *Einführung in die Grammatik der Gegenwartssprache*, Tübingen, 1998.  
Valentin, Paul, *Über Nicht-Partizipien und Partizipien im heutigen Deutsch*, në Bresson.

